



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 9225 Prot.

Patos, më 20/08/2024



MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 60, datë 20/08/2024

PËR
MIRATIMIN E FORMATIT TË NJOFTIM/PUNIMEVE QË NUK KËRKOJNË
PAJISJE ME LEJE NDËRTIMI NË ZONA RURALE

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të pikës “k”, të nenit 54, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 6, 6/1, 6/2 të vendimit nr. 377, datë 12.6.2024 për disa ndryshime dhe shtesa të vendimit nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratoj formularin e njoftimit/punimeve për ndërhyrjet në zonat rurale, pjesë përbërëse të këtij projekt-vendimi.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Boreta Murati

Françeska Gjata

Juriste

Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 3225/11 Prot.

Patos, më 20/08/2024

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIM TË NJOFTIM/PUNIMEVE QË NUK KËRKOJNË
PAJISJE ME LEJE NDËRTIMI NË ZONA RURALE

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të pikës “k”, të nenit nr. 54, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 6, 6/1, 6/2 të vendimit nr. 377, datë 12.6.2024 për disa ndryshime dhe shtesa të vendimit nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, si dhe nenit nr. 2, të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësisë të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, janë përcaktuar punimet të cilat nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi ose deklaratë paraprake punimesh do të kryejnë procedurën e njoftimit të ndërhyrjeve sipas kategorive përkatëse të veprimtarive ndërtimore. Neni 6 liston gjithë ndërhyrje të brendshme apo të jashtme që kryhen me njoftim/vetdeklarim kryerjesh punimesh të cilat nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe neni 6/1 të vendimit 377, datë 12.6.2024 “Për disa ndryshime të vendimit 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar përcakton punimet të cilat nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi që janë si më poshtë:

- a. Riparimet e objekteve të rregjistruara dhe çarjet në muret rrethuese, pa çënuar kalimet apo të drejtat e pronave kufitare;
- b. Vendosja e elementëve dekorativ arkitektonik në sistemim;
- c. Punime për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara;
- d. Punime të jashtme, si ndërhyrjet e mirëmbajtjes së zakonshme, kur sjellin ndryshime të karakteristikave apo të formave;
- e. Realizimi i rrethimeve me struktura të lehta, pa themele;
- f. Sistemimi i oborreve me shtresë të hollë betoni;
- g. Struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe/ose të përkohshme, pa themele, me materiale të çmontueshme, pa përdorur struktura betonarmeje, blloqe betoni, muratura e soleta dhe që hiqen në çdo rast, brenda një afati kohor maksimal 12-mujor nga momenti i lëshimit;
- h. Vendosja e pergolateve, në përputhje me ligjin që rregullon bashkëpronësinë në objektet e banimit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. ____ Prot.

Patos, më ____ / ____ / 2024

**NJOFTIM PËR FILLIM PUNIMESH QË NUK KËRKOJNË PAJISJE ME LEJE
NDËRTIMI**

Adresa: _____

Aplikanti: _____ Nr. Kontakti: _____

Specifikim i detajuar i llojit të punimeve

(sipas nenit 6/1 të Rregullores së Zhvillimit)

Punime të jashtme që përfshijnë ndërhyrje të jashtme për riparimin dhe zëvendësimin e rifiniturave të jashtë të ndërtesave dhe oborreve/truallit, pjesë përbërëse të tyre me kusht që të ruhen karakteristikat origjinale si vijon:

- Riparimet e objekteve të rregjistruara dhe çarjet në muret rrethuese, pa cënuar kalimet apo të drejtat e pronave kufitare;
- Vendosja e elementeve dekorative arkitektonike në sistemim;
- Punimet për eliminimin e barrierave arkitektonike dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara;
 - 2.1 Punime të jashtme, si ndërhyrje të mirëmbajtjes së zakonshme, kur sjellin ndryshime të karakteristikave dhe/apo formave
 - 2.2 Punime të tjera si:
 - Realizimi i rrethimeve me struktura të lehta, pa themele;
 - Shtrimi i oborreve me shtresë të hollë betoni;
 - Struktura që instalohen për nevoja të çastit dhe/ose të përkoshme, pa themele, me materiale të çmontueshme pa përdorur struktura betonarmeje, blloqe betoni, muratura e soleta dhe që hiqen në çdo rast, brenda një afati kohor maksimal 12 mujor nga momenti i lëshimit;

- Zëvendësimi i pjesshëm i mbulesës së çatisë, pa ndonjë ndryshim të formës, pjerrësisë dhe karakteristikave të veshjes;
- Riparim dhe zëvendësim i ulluqeve dhe oxhakëve edhe me materiale të ndryshme;
- Riparim i ballkoneve, tarracave dhe basamakëve apo barrierave mbrojtëse;
- Vendosja e hekurave mbrojtës në dritare;
- Vendosja e tendave të diellit dhe rrjetave kundër mushkonjave;
- Sistemimi i oborreve;
- Sistemim i shtresave të dheut, po jo betonizimin e tyre;
- Riparim i rrethimeve ekzistuese;
- Realizimi i rrethimeve me struktura të lehta, pa themele;
- Shtrimi i oborreve me shtresë të hollë betoni;
- Riparimet dhe çarjet pjesore në muret rrethuese, pa çënuar kalimet apo të drejtat e pronave kufitare;
- Vendosja e parapeteve;
- Vendosja e elementeve dekorative arkitektonike në sistemim;

1.2 Ndërhyrje të brendshme:

- Riparim dhe rinovim i dyshemeve;
- Riparim dhe restaurim i suvasë, veshjeve dhe ngjyrave;
- Riparim dhe rinovim i dyerve dhe dritareve përfshirë vendosjen e xhamave të dyfishtë;
- Hapja dhe mbyllja e dyerve të brendshme.
- Krijimi, eliminimi ose ndryshimi i mureve ndarës (jombajtës) të brendshëm.
- Realizimi i impianteve të reja higjieno-sanitare dhe të ngrohjes/ftohjes;

1.3 Ndërhyrje në impiante higjieno-sanitare dhe elektrike, si:

- Veprat e riparimit dhe zëvendësimit të pajisjeve higjieno-sanitare dhe riparimet e impiantit;
- Veprat e riparimit dhe të zëvendësimit të pajisjeve elektrike dhe riparimet e sistemeve elektrike.
- Lëvizjet e dheut që lidhen në mënyrë të posaçme me ushtrimin e veprimtarisë bujqësore apo blegtorale, përfshirë ndërhyrjet në impiantë hidraulike bujqësore;